



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Thirrje për Projekt Propozime në fushën e Turizmit

Një nga aspektet më kritike të turizmit në Shqipëri është sezoni turistik relativisht i shkurtër. Një turizëm i suksesshëm dhe kualitativ sigurisht varet nga të qenit në treg gjatë gjithë vitit. Natyrisht që ka përqëndrim të turistëve gjatë sezonit veror, por Shqipëria ka potencialin të njihet si një destinacion për tu vizituar, gjatë gjithë vitit. Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të forcojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit në Shqipëri, duke inkurajuar zgjerimin e sezonit turistik nëpërmjet promovimit mediatic të produktit turistik vendas si dhe duke e diversifikuar atë me modele inovative. Duke pasur parasysh këto objektiva kryesore, thirrja e dytë e këtij viti është e ndarë në dy tematika:

1. Promovimi i atraksioneve turistike, industrisë së mikpritjes nëpërmjet aktiviteteve mediatike dhe inovative

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka turizmi për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale të rajoneve të ndryshme.
2. Zhvillimi dhe përmirësimi i produkteve turistike specifike, në përputhje me kërkesën gjithnjë në rritje për paketa turistike lokale, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese.

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të veçantë me synim: argëtimin dhe shkëmbimin e eksperiencës.
- Zhvillimin e produktit turistik të kërkuar gjatë gjithë vitit duke kontribuar kështu në diversifikimin e grupeve të synuara (aktivitete të ndryshme me tematikë etnografinë, trashëgiminë kulturore, turizmin kulturor, turizmin e aventurës, gastronominë etj)